



Kjo pasqyrë publikohet në interes të informimit sa më të drejtë dhe në kohë të qytetarëve mbi zhvillimet ekonomike në vend. Përmes mënyrave të tilla të komunikimit Ministria e Financave mundohet që të shfrytëzojë të dhënat e disponueshme nga institucionet e vendit për të dhënë një pamje të përmbledhur mbi ekonominë në vend.

Ky është numri i parë i pasqyrës ku janë ofruar përkrah njëra tjetrës të gjeturat nga të dhënat për regjistrimin e bizneseve të reja me perceptimin e bizneseve për klimën në vend. Këtu kemi parë se sektori i prodhimit ka dhënë sinjale pozitive ku vlerësimet dhe pritjet e bizneseve për klimën janë premtuese, por edhe kemi parë një numër më të madh të bizneseve të regjistruara në këtë sektor.


Sektori Real

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2015 u rrit me një normë reale prej 3.6%, shifër kjo që mbetet vlerësim meqë ende nuk janë të gatshme të dhënat finale lidhur me këtë tregues.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) së fundmi ka publikuar Bruto Produktin Vendor (BPV) në baza tremujore (TM) deri në tremujorin e tretë të vitit 2015, paraqitur në grafikun 1 më poshtë.


Shohim nga grafiku sezonalitetin e theksuar, që arrin vlerën më të lartë gjatë muajve korrik-gusht-shtator.

Grafiku 1. BPV sipas qasjes së shpenzimeve, me çmime konstante (në milionë euro)



Nga grafiku 2 shohim se çmimet mbajtën nivel të njëjtë me periudhën paraprake dhe se vazhdojnë të përcjellin ngushtë nivelin e çmimit të produkteve ushqimore.

Grafiku 2. Indeksi i Çmimit të Konsumatorit



Gjatë periudhës janar – mars të këtij viti u shënuar inflacion prej 0.1% në mesatare.

Për të kuptuar më shumë mbi gjendjen e ekonomisë në vend, u referohemi treguesve siç janë numri i bizneseve të regjistruara dhe perceptimet e bizneseve mbi klimën në vend.

Sipas Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë gjatë kësaj periudhë u regjistruan 2299 biznese, prej të cilave mbi 800 në sektorin e tregtisë, ndërkaq mbi 300 në prodhim.

Tabela 1. Numri i bizneseve të regjistruara

Sektori i regjistrimit të biznesit	TM1 2015	TM1 2016
Tregti me shumicë dhe pakicë	784	820
Prodhim	276	343
Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	255	261
Ndërtimtari	237	254
Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	253	249
Të tjera	286	372
Totali	2091	2299


Vlen të theksohet se nga kategoritë më sipër, në krahasim me periudhën e njëjte të vitit të kaluar më së shumti janë regjistruar biznese në sektorin e prodhimit; rreth 24% më shumë.

Kjo rritje paraqet një numër relativisht të vogël (prej 67 biznesesh), por duke pasur parasysh bazën e ulët (në krahasim me sektorin e Tregtisë), vlerësohet të jetë sinjal pozitiv.

Kjo përkon edhe me perceptimet e bizneseve të cilat në këtë publikim e analizohen përmes anketës mbi klimën e biznesit, realizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës.

Grafiku 3 paraqet pozitën e sektorëve të dhënë sipas vlerësimeve të tyre dhe lëvizjes nga ky vlerësim krahasuar me periudhën paraprake (në pikë përqindjeje).


Grafiku 3. Klima e biznesit në TM1 2015



Në tremujorin e parë të vitit 2015 situata ishte vlerësuar përgjithësisht negative, ku të gjithë sektorët ishin koncentruar tek kuadrati poshtë-majtas.

Ndërkaq shohim se në periudhën aktuale bizneset kanë vlerësuar shumë më pozitivisht klimën, gjë që vlen veçanërisht për sektorin e prodhimit. Shohim se ka përmirësim të dukshëm në pozitën e secilit sektor.


Grafiku 4. Klima e biznesit në TM1 2016



Ndërkaq, grafiku 5 jep pritjet e bizneseve mbi klimën që ata presin për muajt në vijim.

Janë veçanërisht premtuese pritjet pozitive të sektorit të shërbimeve dhe atij të prodhimit.

Grafiku 5. Pritjet e bizneseve në TM1 2016 për gjashtë muajt e ardhshëm



Bizneset mund të jenë duke bazuar pritjet e tyre në ndryshimet e fundit fiskale që ka ndërmarrë Qeveria në drejtim të stimulimit të bizneseve përmes lirimeve për linjat e prodhimit dhe pajisjet e TI-së, meqë këto hynë në fuqi nga fundi i vitit të kaluar, më saktësisht, pas shtatorit të 2015-tës.

Sektori i Jashtëm

Tregtia e jashtme vazhdon të mbajë trendet e deritanishme, ku përgjatë periudhës janar-mars të këtij viti u importuan mallra në vlerë prej mbi 500 milionë euro.

Tabela e mëposhtme tregon katër grupe produktesh që përbejnë rreth gjysmën e importit total.

Tabela 2. Importi sipas produkteve, në '000 euro

Kategoria	TM1 2015	TM1 2016
Ushqim, pije, duhan	25,880	71,477
Produkte minerale	86,548	61,660
Metale bazë dhe artikuj prej tyre	38,201	52,721
Makineri, pajisje makinerike e elektrike	55,917	69,521
Të tjera	292,671	306,457
Totali	499,217	561,836

Mbi 40% e importit total vjen nga Bashkimi Evropian, ndërkaq 30% nga shtetet e CEFTA-s. Në tabelën më poshtë janë paraqitur disa prej shteteve prej të cilave Kosova importon më së shumti (që përbejnë mbi gjysmën e importit total).

Shohim se ka një rritje prej 13% të importit nëse krahasojmë me periudhën e njëjtte të vitit paraprak, ku më së shumti është rritur importi nga Gjermania dhe Turqia, ndërkaq importi nga Serbia ka shënuar një

rënie të lehtë prej 2%, megjithëse vlera e importit nga ky shtet vazhdon të mbetet më e larta.

Tabela 3. Importi sipas shteteve, në '000 euro

Shteti	TM1 2015	TM1 2016
Gjermania	54,736	72,858
Italia	37,245	39,271
Serbia	80,287	78,835
Turqia	42,854	59,908
Kina	48,544	53,369
Të tjera	235,551	257,595
Total	499,217	561,836

Në anën tjetër, eksporti përgjatë kësaj periudhe arriti në mbi 70 milionë euro, ku shohim nga tabela se rreth 60% përbëhet nga produktet minerale dhe metalet bazë;

Tabela 4. Eksporti sipas produkteve, në '000 euro

	TM1 2015	TM1 2016
Produktet minerale	2,762	10,135
Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	47,235	33,484
Të tjera	26,032	28,317
Total	76,029	71,936

Edhe pse kategoria e metaleve bazë përbën 48% të eksportit total, shohim se në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ka një rënie prej 30% të eksportit të këtij produkti, rënie kjo që mund t'i atribuohet rënies së çmimit të metaleve në nivel global gjatë vitit të kaluar.

Mbi gjysma e eksporteve kosovare u destinuan në shtetet e BE-së dhe në shtetet e CEFTA-s. Në tabelën më poshtë janë shkëputur disa prej shteteve në të cilat është eksportuar më së shumti gjatë kësaj periudhe:

Tabela 5. Eksporti sipas shteteve, në '000 euro

	TM1 2015	TM1 2016
Italia	9,800	1,287
Shqipëria	8,449	7,528
Maqedonia	7,044	6,151
Serbia	3,316	5,368
India	15,373	5,146
Të tjera	32,047	46,456
Total	76,029	71,936

Rënia e çmimit të metaleve gjatë vitit 2015 pati për pasojë ndryshimin e strukturës së tregtisë me metale në nivel global, kjo për shkak të ndikimit të Kinës si akteri kryesor në industrinë e sotme.


Duke pasur parasysh se eksporti kosovar dominohet nga metalet kjo ka ndikuar edhe në strukturën e

eksportit tonë, duke rezultuar në një rënie për 5% të eksportit total. Megjithatë vlen të theksohet se ka një rritje prej rreth 4 milionë euro të eksportit në Serbi dhe se në përgjithësi, eksporti për në BE dhe shtetet e CEFTA-s vazhdon të ruajë trendët ekzistuese.

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore performuan mirë gjatë kësaj periudhe, ku rritje më të theksuar patën të hyrat nga kufiri; prej rreth 26% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2015.


Grafiku 6. Të hyrat, në milionë euro



Shpenzimet në anën tjetër mbajtën nivele të përafërta me ato të periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, duke shënuar një rritje prej 12% të shpenzimeve totale.


Vlen të theksohet se kjo rritje erdhi kryesisht si pasojë e ekzekutimit të shpenzimeve kapitale (të projekteve infrastrukturore) të cilat u realizuan në vlerë prej mbi 50 milionë euro vetëm gjatë kësaj periudhe (krahasuar me rreth 30 milionë euro në TM1 2015).

Grafiku 7. Shpenzimet, në milionë euro



Ndërkaq, në grafikun 8 janë paraqitur të hyrat dhe shpenzimet në raport me deficitin primar.

Grafiku 8. Të hyrat, shpenzimet dhe deficitin primar



Sektori Financiar

Sektori financiar në Kosovë mbetet i kapitalizuar mirë, ku sipas Bankës Qendrore të Kosovës, shohim se depozitat shënuan një rritje të lehtë prej 3%, ndërsa kreditë u rritën me 7% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2015. Asetet totale shënuan rritje prej 5%, duke arritur në afro 3.4 miliardë euro në fund të periudhës.

Tabela 6. Depozitat dhe kreditë në sektorin financiar, kumulative, fundi i periudhës (në milionë euro)

	TM1 2015	TM1 2016
Depozitat	2,575	2,664
Kreditë	1,936	2,069
Asetet Totale	3,250	3,398

Banka Qendrore ofron edhe të dhëna mbi shpërndarjen e kredive nëpër sektorë të ekonomisë, prej ku mund të shohim se në përgjithësi ka pasur rritje prej 6% të kreditimit total.

Kjo rritje është shtyrë nga rritja e kredive në sektorin e Shërbimeve financiare, patundshmërive, etj., dhe sektorin e Bujqësisë. Megjithatë vlera e kredive në këtë të fundit është e vogël, rritja prej rreth 9% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është sinjal pozitiv, veçanërisht duke pasur parasysh ato që u diskutuan në seksionin real (më sipër) të këtij publikimi lidhur me bizneset dhe perceptimet e tyre.

Tabela 7. Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik (në milionë euro)

	TM1 2015	TM1 2016
<i>(kumulative, fundi i periudhës)</i>		
Bujqësia	50	54
Industria dhe energjetika	195	209
Ndërtimtaria	104	99
Tregtia me shumicë dhe pakicë	678	702
Shërbimet fin.explat., patundshmëri, qira, etj.	75	96
Shërbimet tjera	172	192
Gjithsej	1,274	1,352

Tabelë përmbledhëse

Përshkrimi	TM1 2015			TM1 2016		
	Janar	Shkurt	Mars	Janar	Shkurt	Mars
<i>në milionë euro, përveç ku ceket ndryshe</i>						
Sektori Real						
Bruto Produkti Vendor	:	:	1186	:	:	:*
IÇK (ndryshimi në %, mujore)	-0.6	-0.3	-0.4	0.2	0.1	0.1
Sektori i Jashtëm						
Importi i mallrave	137	164	198	133	194	236
Eksporti i mallrave	26	23	26	22	24	26
Bilanci tregtar	-111	-110	-141	-170	-172	-210
Sektori Fiskal						
Të hyrat e përgjithshme <i>prej te cilave:</i>	99	82	105	111	102	117
Të hyrat nga kufiri	47	52	68	52	74	84
Të hyrat vendore	41	21	22	44	21	22
Shpenzimet e përgjithshme <i>prej te cilave:</i>	70	109	107	78	119	129
Shpenzimet rrjedhëse	70	97	88	77	101	97
Shpenzimet kapitale	0	13	19	1	18	32
Deficiti primar	29	-27	-2	33	-17	-12
Sektori Financiar <i>(kumulative, fundi i periudhës)</i>						
Depozitat	2547	2554	2575	2671	2664	2664
Kreditë	1863	1863	1936	2005	2026	2069
Asetet totale të sektorit financiar	3213	3224	3250	3371	3373	3398

Burimet: Agjencia e Statistikave të Kosovës
Banka Qendrore e Kosovës
Thesari i Kosovës, Ministria e Financave
Oda Ekonomike e Kosovës

(:) – nuk ka të dhëna; në këto raste, të dhënat janë të disponueshme vetëm për tremujorin si periudhë e tërë

* të dhënat nuk janë të gatshme në kohën e publikimit të kësaj Pasqyre

Përdorimi i të dhënave nga ky publikim lejohet vetëm me citimin e burimit. Pasqyra publikohet çdo tremujor dhe çdo përmirësim bëhet në faqen zyrtare në internet

Departamenti për Politika Ekonomike dhe Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar
Njësia e Makroekonomisë
Maj 2016